



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1031 / 6 prot.

Tiranë më 23.07.2021

REKOMANDIM

Nr. 38, datë 23. 7.2021

PËR KONTROLLUESIN "TORONTO GROUP" SHPK
(SPITALI JO PUBLIK AMAVITA)

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Toronto Group*" SHPK (*Spitali Jo-Publik Amavita*),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.90, datë 21.06.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Toronto Group*" SHPK, (*Spitali Jo-Publik Amavita*), (në vijim "*Kontrolluesi*"), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare: *Import-Eksport mallrash të ndryshme para farmaceutike, shërbime mjekësore e farmaceutike. Shërbime mjekësore, Qendër Spitalore jopublike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjet për shërbimet shëndetësore trans kufitare. Shërbime Mjekësore dhe Farmaceutike, të licensuar nga organet kompetente, etj.*

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij tregtare, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës”, “pacientë”, “klientë” dhe “furnizues”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike. Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat për kohën e ruajtjes së të dhënave, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në germën “d” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë përpunuar të dhënat personale. Në momentin që qëllimi ka përfunduar lind detyrimi që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një palë e tretë në cilësinë e përpunuesit, të realizojë shkatërrimin/fshirjen e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm;

2. Kontrolluesi nuk ka parashikuar politika privatësie në faqen e tij të internetit www.spitaliamavita.al, në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave “pacientë”, mbi qëllimin dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49, datë 02.03.2020 “Për mbrojtjen e të dhënave shëndetësore” (në vijim, “Udhëzimi nr. 49”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre njohjen me të drejtat që iu janë akorduar në Kushtetutë dhe Ligj, si dhe ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

3. Kontrolluesi ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me përpunuesit, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe Shoqëria Swiss Medical Center SH.P.K. Rezulton se në kontrata nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, Udhëzimi nr. 19).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave. Ky detyrim është përmbushur nga Kontrolluesi pasi ka filluar hetimi administrativ.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim dhe përditësimi mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen e sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave të subjekteve të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.49, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), si dhe është një sistem i çertifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të pajisjes me “*Deklarata Konfidencialiteti*”, të punonjësve që kanë akses e përpunojnë të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve të të dhënave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të *Kodit të Procedurave Administrative*, Kontrolluesi është ftuar nga ana e Komisionerit përpara marrjes së vendimit të tij përfundimtar, të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, ka pranuar shkeljet e konstatuara si dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Kontrolluesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, të gjithë dokumentacionin, sipas të cilit provohej përmbushja e detyrimeve që burojnë nga ligji, si dhe nga konstatimet e hetimit administrativ të ushtruar pranë këtij kontrolluesi.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe angazhimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale, si dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të Kreut II të Ligjit dhe neneve 18, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1 germa, a/1, si dhe nenit 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdimësi të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
3. Kontrolluesi të ketë në vëmendje përmbushjen e detyrimeve në vazhdimësi, të parashikuara në nenet 21 dhe 22 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të ketë në vëmendje masat e sigurisë në drejtim të garantimit të procesit përpunimit të të dhënave në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen, si dhe teknologjitë bashkëkohore;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
6. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;

Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 23. 7 .2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

